

Syllabusi i lëndës

Lënda: Kuran II

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 207

Fondi i orëve: 3+3

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: -IV-

Mësimdhënësi: Hfz. Mr. sci. Afrim Bulliqi

Përshkrim i shkurtër i lëndës:

Lënda e Kuranit II është një nga lëndët më vitale të FSI-së. Kjo lëndë do të avancoj edhe më rregullat dhe konditat e drejtkëndimit që dalin nga shkenca përkatëse e njohur me emrin "Texhvid". Kurani II do të trajtoj artikullimin e nyjëtimin e saktë të shkronjave arabe, duke respektuar tingujt dhe veçoritë e akustikës burimore e natyrore të tyre. Po ashtu pritet që të avancohen këto kompetenca pastaj edhe me rregullat e veçanta precize që ndërlidhen me zgjatimet, pushimet dhe rifillimin e leximit. Kur'ani II do të kulmoj me rezultate konkrete në drejtkëndim duke i zbritur të gjitha këto kompetenca, në kontuniitet me aspektin teorik, në rrafshin e praktikës.

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë rreth vlerës së leximit-këndimit të Kuranit famëlartë rregullave dhe konditave të drejtkëndimit që dalin nga shkenca përkatëse e njohur me emrin "Texhvid". Dhe atë me aftësimin e studentëve në artikullimin e nyjëtimin e saktë të shkronjave arabe, duke respektuar tingujt dhe veçoritë e akustikës burimore e natyrore të tyre dhe më pas lidhjen e tyre në fjalë dhe leximin e rrjedhshëm të atyre fjalëve në fjalitë e ajeteve-verseteve Kur'anore. Po ashtu pritet që të avancohen këto kompetenca pastaj edhe me rregullat e veçanta precize që dalin nga shkenca e Texhvidit të ndërlidhura me shkrirjet, formimet dhe zgjatimet e veçanta të disa tingujve komfor standardeve që përcakton kjo lëmi. Dhe aftësimi kulmor arrihet duke i zbritur të gjitha këto kompetenca, në kontuniitet me aspektin teorik, në rrafshin e praktikës nga ana e studentëve nën vëzhgimin dhe bashkëpunimin e vazhduar të profesorit. E tëra kjo pritet të rezultojë me nivel cilësor e të kënaqshëm të drejt lexim-këndimit të Kur'anit famëlartë nga ana e studentëve që përcjellin dhe angazhohen në këtë kurs.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj rregullat e lexim-këndimit të drejt të Kur'anit famëlartë.

Të krahasoj veçoritë e leximit të saktë me atë jo të saktë.

Të diskutoj rreth vlerave, rëndësisë dhe rregullave të leximit të Kur'anit famëlartë.

Të argumentojë- të arsyetojë të gjitha kompetencat e fituara me argumentet përkatëse.

Të aftësoj të tjerët me të njëjtat kompetenca pas përfundimit në tërësi me të gjithë semestrat e tij.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të shfrytëzohen pajisjet e projektorëve për prezantimin e njohurive në formë të slljadeve me programin Power Point. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupe, dhe teste të vetëvlerësimit. Dhe të tëra këto do të plotësohen me zbatimin e tyre në praktikë duke i implementuar në lexim-këndimin e studentëve para profesorit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve në mësim dhe sukses të studentëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Zgjatimet dhe llojet e tyre, njoftim i përgjithshëm me natyrën dhe burimin e këtyre zgjatimeve në gjuhën arabe. Zgjatimi i natyrshëm burimor, rastet e formimit të tij, masa e zgjatjes dhe norma e tij. Zgjatimi i ndërrimit, rastet e formimit të tij dhe masa e zgjatjes së tij. Zgjatimi i zëvendësimit dhe norma e tij. Zgjatimi i lidhjes së vogël rastet e zgjatjes së tij dhe përjashtimet nga rregulla e tij. Lexim-këndim.

Literatura: (f. 99-104)

Java e dytë: Zgjatimet jo të natyrshme ose jo burimore. Llojet e tyre dhe shkaqet e formimit. Zgjatimi i domosdoshëm i bashkëngjitur Zgjatimi i lejuar i ndarë, rastet e formimit të tij dhe norma e masa e zgjatjes së tij. . Përsëritje e materialit paraprak të ligjëratave të kaluara. Lexim-këndim.

Literatura: (f.105-108)

Java e tretë: Zgjatimi i lidhjes së madhe. Zgjatimet e domosdoshme për shaka të sukunit të përhershëm dhe njoftim me llojet e tij në përgjithësi. Zgjatimi për shkak të sukunit. Përsëritje të materies nga ligjëratat paraprake. Lexim-këndim

Literatura: (f. 108-109).

Java e katërt: Zgjatimi i domosdoshëm i shkronjës, rastet, llojet dhe norma e tij. Mënyra e leximit të bashkëtingëlloreve simbolike në fillim të disa sureve . Përsëritje të materies nga ligjëratat e kaluara Lexim këndim.

Literatura: (f. 109-110).

Java e pestë: Zgjatimi për shkak të sukunit të rastit, format, llojet dhe normat e tyre. Përsëritje të materies nga ligjëratat e kaluara, Lexim- Këndim. Organizimi i testit të parë duke i ndarë studentët në dy grupe.

Literatura: (f. 111)

Java e gjashtë: Analiza e rezultateve të testit të mbajtur me anë të bisedës interaktive. Lexim-këndim. Takimi i më shumë shaktarëve të zgjatimit-cilit i jepet prioritet? Lexim-Këndim

Literatura: (f. 111-112)

Java e shtatë: Përmbyllje e kapitullit të katërt me një përsëritje gjithëpërfshirëse të njohurive më të rëndësishme nga ligjëratat e kaluara. Lexim- Këndim.

Literatura: (f. 99-113)

Java e tetë: Hyrje në kapitullin e pestë - Rregullat rreth ndaljeve dhe fillimit gjatë këndimit të Kur'anit famëlartë. Trajtim i përgjithshëm përgatitor për atë të detajuar. Lexim-këndim. Llojet e ndaljeve gjatë këndimit të Kuar'nit. Ndalja vullnetare, llojet e saj dhe rregullat e çdo njëres prej tyre. .Lexim-këndim.

Literatura: (f. 113-117)

Java e nëntë: Ndalja provuese dhe rregullat e saj. Ndalja e detyrueshme dhe rregullat e saj. Ndalja e padrejtë dhe rregullat e saj. Përsëritje nga ligjëratat e kaluara. Sekteja, vendet e saj në Kur'an dhe specifikat e saj. Lexim-këndim.

Literatura: (f. 117-120)

Java e dhjetë: Shenjat e ndaljes dhe çfarë simbolizon çdo njëra prej tyre. Lexim-këndim.Përsëritje nga ligjëratat paraprake. Lexim-këndim Organizimi i testit të dytë duke i ndarë studentët në dy grupe.

Literatura: (f. 121-123).

Java e njëmbëdhjetë: Mënyrat e ndaljes në fund të fjalëve. Diskutim me studentë në mënyre interaktive rreth rezultateve të pritura dhe atyre të arritura. Lexim-këndim.

Literatura: (f. 123-126).

Java e dymbëdhjetë: Rregullat e shkronjës "taun" dhe specifikat e saj. Përsëritje nga ligjëratat e kaluara. Lexim-këndim. Gabimet gjatë këndimit të Kur'anit, llojet e tyre dhe norma e çdo njërit nga to. Lexim-këndim.

Literatura: (f. 126-131).

Java e trembëdhjetë: Rregullat e disa fjalëve që vijnë të ndara dhe të lidhura në mes veti. Lexim-këndim. Rreth eliminimit dhe ngulitjes së disa bashkëtingëlloreve. Rastet e Elifit dhe rregullat përkatëse. Lexim- këndim.

Literatura: (f. 132-138).

Java e katërbëdhjetë: Rregullat e eliminimit të vavit, jaun lamit dhe të nunit. Përsëritje nga ligjëratat paraprake. Përsëritje nga ligjëratat e mëparshme. Lexim-këndim

Literatura: (f. 138-141).

Java e pesëmbëdhjetë: Përmbyllje e smestrit me një përsëritje gjithëpërshirëse e diskutime interaktive dhe provokim i kompetencave të arritura për gjatë këtij cikli ligjëratash.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Testi i I- rë 20%

Testi i II- të 20%

Provimi final 50%

Total 100%

Literatura obliguese:

1. Kur'ani fisnik

2. Emin Behrami, Shkenca e Texhvidit, Prishtinë, 2000

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Imam Neveviu, Rijadu Salihin, kapitulli mbi këndimin e Kur'anit.

2. Dr. Qazim Qazimi, Libër mësimi i arabishtes (për fillestar), Prishtinë 2010

3. Dr. Musli Vërbani, Texhvidi shkenca e të lexuarit (kënduarit) të Kur'anit, Kaçanik 2008

4. Mahmud Halil elHusari, Ahkam Kiraetil Kur'anil Kerim, elMektebetul Mekkije-darul beshair elislamije 1999.